



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I78-4 Prot.
Nr. Dok. 202001730/4

Tiranë 5.11.2020

Lënda : *Rekomandim për ushtrimin e funksioneve të Bashkisë Këlcyrë, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Egjiptian, në fshatin Qafrrap, Këlcyrë.*

Drejtuar : **Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë**
Z. Klement Ndoni

Këlcyrë

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në njoftimet e bëra publike në media dhe më konkretisht, në botimin në portalin "Jugunews", në datë 3 Qershor 2020, të një kronike me titull: "Racizëm në fshatin Qafrrap në Këlcyrë ku banohet nga komuniteti Egjiptian, Bashkia nuk heq plehrat apelojnë banorët: Paguajmë taksën e pastrimit, ejani të hiqni plehrat!", në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj problematike, që lidhet me kushtet e jetesës së këtij komuniteti.

Problematika e paraqitur në këtë kronikë ka të bëjë jo vetëm me detyrimin e ushtrimit të kompetencave nga ana e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e shërbimeve publike, por ajo lidhet drejtëpërdrejtë edhe me cilësinë dhe kushtet e jetesës së një komuniteti banorësh, pjesë e minoritetit kombëtar Egjiptian në vendin tonë, në kushtet e pandemisë së "Covid-19", gjë që e bën çështjen edhe më sensitive.

Në këto rrethana, kemi kërkuar nga ana e institucionit të Bashkisë Këlcyrë, dhënien e një informacioni shpjegues për trajtimin e kësaj problematike dhe të masave që janë marrë nga ana e këtij institucioni për këtë çështje, përgjatë kësaj periudhe problematike të shkaktuar nga pandemia e "Covid-19".

Në përgjigjen e kthyer nga ana e Bashkisë Këlcyrë, me shkresën me nr.1966 datë 7.07.2020, na është bërë me dije ndër të tjera shprehimisht se:

"- Për sa i përket problemit të heqjes së mbetjeve urbane, zona e fshatit Qafrrap, në datën 18.06.2020, është përfshirë në planin e bashkisë dhe atë të prefekturës Gjirokastrë, si zonë

me rrezik ndotjeje ku do të organizohet aksioni i pastrimit të saj. Me datën 4 dhe 5 korrik 2020, me aksion u pastrua gjithë zona e fshatit Qafrrap nga punonjësit dhe mjetet e bashkisë.

- Pretendimi i tyre se paguajnë taksë pastrimi nuk qëndron pasi në këtë fshat si dhe në disa fshatra të tjerë ku infrastruktura është e papërshtatshme dhe nuk lejon qarkullimin e automjetit të grumbullimit të mbetjeve, bashkia nuk i ka përfshirë në pagesën e taksës së pastrimit.
- Në asnjë rast nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk ka patur qëndrim racist ndaj këtij komuniteti, siç pretendohet në kronikën e portalit “Jugunews”. Pakicat etnike janë trajtuar gjithmonë me përparësi dhe në mënyrë të barabartë me gjithë shtresat e tjera të popullsisë. Përpyekjet e Bashkisë Këlcyrë për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti janë konkretizuar gjatë periudhës 2016-2018, me rikonstruktimin e 43 banesave të tyre. Edhe gjatë periudhës së pandemisë “Covid 19”, çdo familjeje të këtij komuniteti u janë dhënë ndihma ekonomike sipas mundësive që ka patur bashkia jonë”.

Pavarësisht se nga informacioni i dhënë nga ana e Bashkisë Këlcyrë, në pamje të parë duket që problematika e paraqitur në portalin “Jugunews”, ka gjetur zgjidhje, duhet theksuar konstatimi i lehtë i atyre elementëve që identifikojnë në të vërtetë thelbin e problematikës dhe shkaqet që kanë çuar në krjimin e kësaj situate.

Sikurse edhe konstatohet në përgjigjen e dhënë nga ana e Bashkisë Këlcyrë, janë disa probleme ekzistuese, të ndërlidhura mes tyre në këtë çështje.

Së pari, është cilësimi i zonës së Qafrrapit në dokumentet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si zonë me rrezik ndotjeje.

Së dyti, në fshatin Qafrrap ku jeton një komunitet Egjiptian, infrastruktura është e papërshtatshme dhe realisht në atë gjendje, sa nuk lejon qarkullimin e automjetit të grumbullimit të mbetjeve urbane. Pra, gjendja e infrastrukturës rrugore është realisht serioze.

Së treti, Bashkia Këlcyrë e ka të pamundur të ofrojë shërbimin publik të heqjes së mbeturinave urbane, për këtë zonë që administrohet nga ana e saj, ndaj edhe në këto kushte nuk ka përfshirë në pagesën e taksës së pastrimit, komunitetin Egjiptian të banorëve që jeton atje.

Është për t'u vlerësuar fakti që nga ana e Bashkisë Këlcyrë ka patur veprim për zgjidhjen e problemit të heqjes së mbetjeve urbane, në zonën e fshatit Qafrrap, por që kjo zgjidhje të jetë e qëndrueshme gjykojmë se duhet të analizohen me kujdes shkaqet që kanë krijuar emergjencën mjedisore dhe nevojën e ndërhyrjes për pastrimin e zonës, duke i paraprirë mospërsëritjes me masa parandaluese për mënjanimin e këtyre shkaqeve.

Çfarë tregon kjo gjendje që na është pohuar drejtpërdrejtë nga vet njësia e vetëqeverisjes vendore, ku përfshihet komuniteti Egjiptian i banorëve që jeton në fshatin Qafrrap, Këlcyrë?

1. Infrastruktura rrugore vendore është një nga funksionet, apo kompetencat e veta të organeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Më konkretisht, në pikën 4, të nenit 23, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

- *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore”.*

Gjendja e rënduar e infrastrukturës rrugore që lidh fshatin Qafrrap, me pjesën tjetër të infrastrukturës rrugore vendore në Bashkinë Këlcyrë, tregon se kjo bashki (për arsye që nuk na

janë bërë me dije), nuk ka ushtruar efektivisht kompetencat dhe funksionet e veta ligjore, në fushën e infrastrukturës. Kjo mungesë veprimi sjell pasoja që ndikojnë direkt në cilësinë e jetës të të gjithë komunitetit që banon në zonën ku ndodhet kjo infrastrukturë problematike. Një pasojë e dukshme, e sjellë në vëmendje të publikut në këtë rast nga ana e medias së shkruar “on line”, lidhet me pamundësinë e qarkullimit të mjeteve, të qëllimura për mbledhjen e mbeturinave urbane dhe për pasojë, mosgrumbullimin e këtyre mbeturinave në qendra të banuara, duke përbërë kështu rrezik për shëndetin e banorëve që jetojnë atje, si dhe për ruajtjen e një mjedisi të pastër.

2. Një tjetër funksion në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, i bashkive, si njësi bazë të vetëqeverisjes vendore, i përcaktuar në pikën 10, të nenit 23, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, është siç përcaktohet shprehimisht, funksioni për:

“Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”.

Përmbushja e këtij funksioni nënkupton ushtrimin e kësaj kompetence ligjore por njëkohësisht edhe detyrimi ligjor, në çdo kohë dhe në të gjithë territorin e administruar nga ana e Bashkisë Këlcyrë, përfshirë këtu edhe fshatin Qafrrap. Cilësimi i zonës së Qafrrapit në dokumentet e njësive të vetëqeverisjes vendore, si zonë me rrezik ndotjeje, tregon se kompetenca e sipërcituar e Bashkisë Këlcyrë nuk është përmbushur. Jo vetëm kaq, por mund të thuhet se kjo njësi e vetëqeverisjes vendore është “dorëzuar” para gjendjes së krijuar dhe një fakt i padiskutueshëm për këtë është pohimi i bërë në shkresën e Bashkisë Këlcyrë, nr.1966 datë 7.07.2020, ku thuhet se:

“Pretendimi i tyre se paguajnë taksë pastrimi nuk qëndron pasi në këtë fshat si dhe në disa fshatra të tjerë ku infrastruktura është e papërshtatshme dhe nuk lejon qarkullimin e automjetit të grumbullimit të mbetjeve, bashkia nuk i ka përfshirë në pagesën e taksës së pastrimit”.

Ushtrimi normal i kompetencave nuk është dhe nuk mund të jetë i justifikueshëm përmes veprimeve të shkëputura të Bashkisë Këlcyrë, që në këtë rast janë emërtuar “aksion për pastrim”, por duhet të jetësohet përmes veprimtarisë së vazhdueshme normale në këtë komponent të shërbimeve publike.

Mospërfshirja e banorëve të komunitetit Egjiptian që banon në fshatin Qafrrap, në pagesën e taksës së pastrimit, në dukje një lehtësim fiskal ndaj tyre, në fakt prezanton një problematikë që lidhet me moskryerjen e një aktiviteti të detyrueshëm nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në kushtet e jetesës së këtij komuniteti.

3. Duke u rikthyer tek çështja e mospërfshirjes së komunitetit Egjiptian që banon në fshatin Qafrrap, në pagesën e taksës së pastrimit, duhet theksuar se kjo situatë tregon për mungesë të të hyrave publike në buxhetin e Bashkisë Këlcyrë, të nevojshme për realizimin e veprimtarisë dhe funksioneve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte nuk mund të thuhet se ky mosveprim i Bashkisë Këlcyrë, përbën një lloj “subvencionimi” ndaj pjesëtarëve të komunitetit Egjiptian, të fshatit Qafrrap, përkundrazi, situata prezanton mosveprim që passjell efekte negative direkte dhe indirekte, për vet njësinë bazë të vetëqeverisjes vendore por edhe për këtë komunitet.

Kjo njësi e vetëqeverisjes vendore duhet të udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, parim i cili në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet se; “... është e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në

kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

Bashkia Këlcyre, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, në këtë kuptim është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim sa efikas, aq edhe afër qytetarit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 15, i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, “të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme” dhe si bazë të gjithë rendit tonë juridik, duke sanksionuar kështu barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët, të cilët, jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në ushtrim të funksionit të tij kushtetues, Avokati i Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, një ndër prioritetet e punës së tij ka mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare, ku përfshihet edhe minoriteti kombëtar Egjiptian.

Në këtë këndvështrim, një nga aspektet sensitive të gjendjes aktuale të minoritetit Egjiptian në Shqipëri, është ai që ka të bëjë me kushtet e jetesës të komuniteteve Egjiptiane në qendrat kryesore të banimit të këtij komuniteti, të vendosura në të gjithë territorin e vendit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që në rezultante konfigurohet me termin “cilësi e jetës”, term i cili prek drejtëpërdrejtë të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “e drejta për jetën”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale dhe normale të jetesës së këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për komunitetet e individëve pjestarë të këtij minoriteti por edhe për shtetin dhe shoqërinë, për mënyrën që ofrohet për përfshirjen dhe integrimin e plotë të individëve, pjestarë të minoritetit Egjiptian, në shoqëri.

Kjo situatë bën që komunitete të ndryshme të këtij minoriteti kombëtar, sikurse edhe në këtë rast, të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Gjendja e krijuar me komunitetin Egjiptian, në fshatin Qafrrap, identifikon nevojën e marrjes së masave të shpejta dhe efikase, për krijimin e kushteve normale të jetesës, në ato komponentë të trajtuar në këtë rekomandim, nga ana e organeve me kompetenca ekzekutive dhe përfaqësuese, të Bashkisë Këlcyre.

Duhet theksuar se, marrja e këtyre masave shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kritereve politike që, Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social- ekonomike, ku përfshihen si subjekte edhe minoritetet kombëtare në vend.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jetese më të mirë për komunitetin, e minoritetit kombëtar Egjiptian, në fshatin Qafrrap, të Bashkisë Këlcyre, bazuar në, nenin 1, të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, ku thuhet shprehimisht se:

“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”,

në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

dhe në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut... ”.*

REKOMANDOJMË

1. Ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të veta ligjore, të Bashkisë Këlcyrë, të parashikuara në pikat 4 dhe 10, të nenit 23, të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, për zgjidhjen e gjendjes së krijuar për komunitetin Egjiptian, që banon në fshatin Qafrrap, të Bashkisë Këlcyrë, sa i përket përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe garantimit të cilësisë së jetesës në një mjedis të pastër, nga mbetjet urbane.
2. Konsiderimin dhe marrjen e masave konkrete, në vazhdimësi, në përmbushje të funksioneve ligjore të Bashkisë Këlcyrë, për të mundësuar përmirësimin e kushteve të jetesës të komunitetit Egjiptian, që banon në fshatin Qafrrap, të Bashkisë Këlcyrë, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,
lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.
Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA